

E drejta për informim

Newsletter mujor mbi mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për të Drejtën e Informimit

Newsletter është publikim i Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Fokusi i muajit

Afati për marrjen e informacionit

Ligji për të drejtën e informimit parashikon se autoriteti publik trajton kërkesën për informim, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj, përveç rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe.

“Ditët e punës” do të thotë nga e hëna deri të premten. Fundjava dhe ditët e festave zyrtare nuk llogariten si ditë pune.

Kur autoriteti publik që merr kërkesën për informim ia dërgon atë një autoriteti tjetër, ai kthen përgjigje jo më vonë se 15 ditë pune nga dita e mbërritjes së kërkesës në autoritetin e parë.

Afati i parashikuar në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, mund të zgjatet me jo më shumë se 5 ditë pune për një nga shkaqet e mëposhtme:

- nevoja për të kërkuar dhe shqyrtuar dokumente të shumta e voluminoze;
- nevoja për t'i shtrirë kërkimet në zyra dhe mjedise që janë fizikisht të ndara nga zyra qendrore e autoritetit;
- nevoja për t'u konsultuar me autoritete të tjera publike përpara marrjes së një vendimi për plotësimin ose jo të kërkesës.

Vendimi për zgjatjen e afatit i njoftohet menjëherë kërkuarës.

Në çdo rast, mostrajtimi i kërkesës për informim brenda afateve të sipërpërmendura do të konsiderohet refuzim.

Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe për njohjen me informacionin arkivor të çdo lloji.

Përmbledhje mujore e vendimeve dhe rekomandimeve

Vendim Nr. 03 - Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë

Vendim Nr. 04 - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Vendim Nr. 05 - Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë

Vendim Nr. 08 - Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë

Vendimmarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP), gjatë muajit shkurt, ka dhënë 4 vendime urdhërimi në zbatim të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (LDI).

Gjatë muajit shkurt të vitit 2021 KDIMDP ka miratuar 4 vendime urdhërimi për autoritetet publike: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Vendimet e dhëna gjatë muajit shkurt nga ana e KDIMDP, u miratuan pas shqyrtimit të disa ankesave të paraqitura nga Birn Albania me objekt "Refuzim të dhënies së informacionit dhe dokumentacionit nga ana e Autoriteteve Publike. Kërkuesi ishte drejtuar me shkresë zyrtare një sërë prokurorive të rretheve gjyqësore dhe gjykatave të rretheve gjyqësore, ku kërkohej informacion/dokumentacion rreth kërkesave të dërguara në gjykatë nga ana e prokurorive të rretheve gjyqësore gjatë periudhës 2010 - 2020 me objekt: "Vendosjen e sekuestros preventive" të pasurive që dyshohet se janë produkt i veprimtarisë kriminale; "Revokimim/heqjen e sekuestros preventive" të pasurive të dyshuara si produkt i veprimtarisë kriminale; "Konfiskimin e pasurisë" si dhe vendimmarrjen përkatëse për këto objekte nga ana e gjykatave.

Gjithashtu nga ana e Autoritetit Publik "Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit" kërkohej informacion si "Lista e pasurive të referuara në Prokurori për sekuestro preventive, për vendosjen e sekuestros dhe pasuritë e identifikuar nga Policia e Shtetit dhe të referuara në Prokurori "Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, kriminit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike" të ndarë sipas viteve dhe e specifikuar llojin e pasurive, vlerën e përlllogaritur të tyre dhe personat që e dispononin atë në momentin e hetimit/referimit; për të njëjtën periudhë kohore.

TRANSPARENCA E AUTORITETEVE
PUBLIKE ËSHTË PARADHOMA
E MIRËQEVERISJES

VIZITONI WWW.IDP.AL

#informim #transparencë #vendim

Në ndjekje të procedurave administrative me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, KDIMDP ftoi palët (kërkuesin e informacionit, prokuroritë e rretheve gjyqësore, gjykatat e rretheve gjyqësore dhe autoritete të tjera publike) në seancë dëgjimore.

Gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar pranë KDIMDP, të gjitha palët paraqitën pretendimet e tyre ku ndër të tjera ngritej shqetësimi nga ana e autoriteteve publike për volumin e madh të informacionit që kërkohej si dhe çështjen e anonimizimit të të dhënave personale. Në përfundim të seancës dëgjimore, Komisioneri kërkoi nga ana e autoriteteve publike të rivlerësonin qëndrimin e tyre në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi dhe veçanërisht duke mbajtur parasysh Udhëzimin nr. 15, datë 23.12.2011 "Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor" të KDIMDP.

Pas përfundimit të seancës dëgjimore, pothuajse të gjitha prokuroritë e rretheve gjyqësore dhe gjykatat e rretheve gjyqësore vendosën në dispozicion të kërkuesit informacionin/dokumentacion e kërkuar.

Në përfundim të procesit administrativ të shqyrtimit të ankesave KDIMDP vendosi Urdhërimin e 4 Autoriteteve Publike dhe konkretisht Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë; Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit; Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë për dhënien e informacionit të kërkuar.

Për më shumë informacion mund të lexoni të plotë vendimet në faqen e KDIMDP www.idp.al.

Në muajin shkurt, Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale paraqiti pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Raportin Vjetor mbi veprimtarinë e Zyrës së Komisionerit për vitin 2020. Ky raport përmbledh arritjet dhe sfidat kryesore të dy të drejtave kushtetuese: "E Drejta për Informim" dhe "E Drejta për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" gjatë vitit 2020. Raporti i Zyrës së Komisionerit mund të lexohet i plotë në faqen zyrtare www.idp.al ndërsa mëposhtë mund të lexoni disa nga të dhënat e monitorimit të të drejtës për informim.




KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

RAPORTI VJETOR 2020

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

www.idp.com

Monitorimi dhe mbikëqyrja e Programit të Transparencës së Autoriteteve Publike



Autoritetet Publike që kanë instaluar REKPDI



Ankesa 2020

